

UDHËZIM
Nr.1, datë 13.1.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3551, DATË 23.7.2003 “MBI REGJISTRIMIN E MJETEVE RRUGORE”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 92 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe pikës 5 të nenit 237 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.3551, datë 23.7.2003 “Mbi regjistrimin e mjeteve rrugore”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 3 pika 6 shkronja “b”, paragrafi i dytë, ndryshohet si vijon:
“Për subjektet juridike, ekstrakt i QKR-së, në origjinal.”.
2. Neni 3, pika 6, shkronja “c” ndryshohet si vijon:
“Kartën e identitetit, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri klientit”.
3. Neni 11, pika 1, shkronja “f” ndryshohet si vijon:
“Kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon targat vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër.”.
4. Neni 11, pika 3, shkronja “e” ndryshohet si vijon:
“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.
5. Neni 11, pika 3, shkronja “h” ndryshohet si vijon:
“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.
6. Neni 11, pika 4, shkronja “e” ndryshohet si vijon:
“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.
7. Neni 11, pika 4, shkronja “g” ndryshohet si vijon:
“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.
8. Neni 13, pika 1, shkronja “h” ndryshohet si vijon:
“Kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon targat, vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër.”.
9. Neni 13, pika 3, shkronja “e” ndryshohet si vijon:
“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.
10. Neni 13, pika 3, shkronja “i” ndryshohet si vijon:
“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.
11. Neni 13, pika 4, shkronja “e” ndryshohet si vijon:
“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat nëse ato janë sipas sistemit të vjetër.”.
12. Neni 13, pika 4, shkronja “g” ndryshohet si vijon:
“I dorëzon klientit targat e reja të mjetit, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër.”.
13. Neni 24, pika 1, shkronja “c” ndryshohet si vijon:
“Kur pronari ndryshon rrethin e vendbanimit, dorëzon shenjë e identifikimit të ciklomotorit, vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.”.
14. Neni 24, pika 3, shkronja “d” ndryshohet si vijon:
“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon shenjë e identifikimit të ciklomotorit, vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.”.
15. Neni 24, pika 3, shkronja “g” ndryshohet si vijon:
“I dorëzon klientit shenjë e re të identifikimit të ciklomotorit, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë

identifikimi të sistemit të vjetër.”.

16. Neni 24, pika 4, shkronja “d” ndryshohet si vijon:

“Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon shenjën e identifikimit të ciklomotorit, vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.”.

17. Neni 24, pika 4, shkronja “e” ndryshohet si vijon:

“I dorëzon klientit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër.”.

18. Në nenin 46, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Përsëritja e autorizimit të provës:

- a) Zyra e regjistrimit bën shënimet përkatëse në regjistrin e targave të provës.
- b) Sipas procedurave të përcaktuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targën vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.
- c) I dorëzon subjektit targën e re të provës, vetëm në rastet kur subjekti ka pasur targë të sistemit të vjetër.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi